



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of
Prishtina



Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, pika c, neni 17, pika f, neni 40, paragrafi 40.2, shkronja a të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dispozitat e neneve 15 dhe 34 të Ligjit nr. 04/L – 060 për Mbeturina, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 08/L-071, nenin 8, pika a, nenin 15, pika f dhe 19 paragrafi 1, Ligjit nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, si dhe në bazë të nenit 15, pika f, nenit 33 e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 Nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur me 05.12.2024, miratoi këtë:

RREGULLORE
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR
MENAXHIMIN E MBETURINAVE, NR. 01-030/01-227581/23, DT. 1.12.2023

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregullore është plotësimi dhe ndryshimi i Rregullores Nr. 01-030/01-227581/23 për menaxhimin e mbeturinave dhe ndërgjegjësimi i publikut drejt riciklimit të mbeturinave.

Neni 2

1. Pas paragrafit 2 të nenit 7, shtohet paragraf i ri 3 me tekstin si në vijim:

3. Operatori publik i kontraktuar nga Komuna e Prishtinës sipas nenit 16 paragrafi 2 të rregullores bazë, është e obliguar të regjistroj dhe mbajë regjistër të klientëve të amvisërisë dhe bizneseve dhe njofton Komunën sipas kërkesës së saj lidhur me përditësimin e regjistrit të klientëve.

Neni 3

1. Paragrafi 1 i nenit 12, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim:

1. Kjo leje zëvendëson licencën për menaxhimin e mbeturinave që më parë është lëshuar nga Ministria e Mjedisit. Kjo leje lëshohet nga Komuna e Prishtinës dhe vlen për operim vetëm në territorin e Komunës së Prishtinës, si dhe ka afat të vlefshmërisë për një periudhë tre (3) vjeçare siç përcaktohet në legjislacionin përkatës në fuqi për lejet mjedisore. Leja mund të vazhdohet pas parashtrimit të kërkesës nga kompania përkatëse në Sektorin e mbrojtjes së mjedisit dhe energjisë eficiente.

Neni 4

1. Paragrafi 2 i nenit 14 të Rregullores bazike, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim:

Faturimi i taksës së mbeturinave për amvisëri apo njësi banimi bëhet në baza mujore nga kompania "Pastrimi" SH.A, kurse fatura i dorëzohet gjeneruesit të mbeturinave përmes inkasantëve të Kompanisë Regjionale "Pastrimi" SH.A. me së largu deri në ditën e dhjetë (10) të muajit pasues dhe pagesa nga gjeneruesi i bëhet direkt kompanisë Pastrimi Sh. A. përveç kategorive të liruara me ligj për të cilat do të kryhet pagesa nga Komuna e Prishtinës Ndërmarrjes publike Pastrimi.

2. Pas paragrafit 2 të nenit 14 të Rregullores bazë shtohet paragraf i ri 2a. dhe 2b. me tekstin si në vijim:

2a. Kompania Pastrimi Sh.A faturon bizneset e vogla, të mesme dhe të mëdha si dhe institucione në Komunën e Prishtinës për të cilat ka kontratë të veçantë dhe ju ofron shërbim.

2b. Pagesa nga bizneset e vogla, të mesme dhe të mëdha si dhe institucione në Komunën e Prishtinës për kryerjen e shërbimit sipas paragrafit 2a. i paguhet direkt kompanisë Pastrimi Sh. A.

Neni 5

1. Paragrafi 1 i nenit 16 të rregullores bazë plotësohet dhe ndryshohet si në vijim:

1. Operatori publik i kontraktuar nga organi kontraktues për ofrimin e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave, është i obliguar të veproj sipas kontratës dhe ligjeve në fuqi.

2. Paragrafi 2 i nenit 16 të rregullores bazë, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim:

2. Operatori publik i kontraktuar nga Komuna e Prishtinës për ofrimin e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave është kompania publike "Kompania Regjionale e Mbeturinave "Pastrimi" SH.A. Kompania Regjionale "Pastrimi" SH.A. është e obliguar të veprojë sipas kontratave të cilat mund të arrihen me Komunën e Prishtinës duke respektuar legjislacionin në fuqi.

3. Paragrafi 3 i nenit 16 fshihet.

Neni 6

1. Pas paragrafit 5 të nenit 18, shtohet paragrafë të ri 6 dhe 7 me tekstin si në vijim:

6. Kompania regjionale Pastrimi Sh. A raporton inspektionit të Komunës në rast të identifikimit të personave juridik për hedhje të mbeturinave të rrezikshme dhe të gjitha mbeturinave të përcaktuara në paragrafin 4 të këtij neni. Raportimi mund të bëhet përmes shkresës, fotografisë, video incizimit ose çfarëdo forme tjetër përmes së cilës identifikohet kryesi i shkeljes.

7. Të hyrat nga gjobitja sipas paragrafit 6 të këtij neni, Komuna mund ti bartë Kompanisë Pastrimi.

Neni 7
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT

01-030/01-161704/24 më 6.12.2024

Fehmi Kupina

Kryesuesi i Kuvendit

